



|                                                                                     |            |
|-------------------------------------------------------------------------------------|------------|
| REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO                             |            |
| AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT<br>AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE<br>ANTI-CORRUPTION AGENCY |            |
| Dep.<br>Dep.<br>Dep.                                                                | 2-D/DPK    |
| Nr. i faq.<br>Broj stranica<br>Nr. pages                                            | 02         |
| Nr. Prot.<br>Bil. prot.<br>Prot. No.                                                | 01-2677/14 |
| Data<br>Datum<br>Date                                                               | 18.07.2014 |



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE  
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 14.07.2014, mori:

### V E N D I M

**I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-1999/14, për z. Xhevat Demaj, ish Anëtar i Kuvendit Komunal në Istog, për shkak se nuk ushtron funksion publik.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

### A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Xhevat Demaj, ish Anëtar i Kuvendit Komunal në Istog, dhe njëkohësisht, person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Në rastin e lartëpërmendur, zyrtari i lartë z. Demaj është hetuar për situatë të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik. Fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, pas së cilës ai është kontaktuar nga zyrtarët e Agjencisë me ç'rast është kuptuar se tashmë ish zyrtari i lartë z. Demaj nuk e ushtron më funksionin e Anëtarit të Kuvendit Komunal në Istog, dhe po ashtu nuk ka asnjë funksion tjetër publik.

Duke u bazuar në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit konsiderojmë se nuk kemi situatë të shkeljes së dispozitave të këtij Ligji, zyrtari i lartë z. Demaj pas dorëheqjes nga funksioni publik mund të ushtroj pozitën e personit të autorizuar në biznesin privat, Sh.P.K "Guri". Prandaj pushojnë hetimet për Konflikt Interesi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

